

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE  
"HELIOS AEROPORT" SH.P.K.**

*Sot, me 12.05.2020, Anxhela Koka, shtetase shqiptare, lindur me 30.04.1986, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal 1654300620, në cilësinë e administratorit të shoqërisë Helios Gastronomi Shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numer unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L32222023L me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr.6, Rruga Besim Alla, Godinë 2 - kateshe, Zona Kadastrale nr.3321, Nr. Pasurie 433/102, Tirane, Shqipëri, në cilësinë e Ortakut të Vetem, përmes këtij akti themeloi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe kete akt.*

Neni 1

**Emertimi**

Shoqëria emërohet "HELIOS AEROPORT" Sh.p.k. (në vijim referuar si "Shoqëria").

Neni 2

**Forma juridike**

"HELIOS AEROPORT" Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në veçanti me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar dhe në përputhje me kete akt.

Neni 3

**Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Durrës, Komuna Nikël, Krujë, Fshati Rinas, Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza".
- 3.2 Ortaku i Vetëm mund të hapë dhe/ose mbyllë filiale, dege, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

**Kohezgjatja**

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të percaktohen përmes vendimit të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionit në fuqi.



Anxhela Koka  
1



Neni 5

**Objekti**

- 5.1 Shoqëria do të ushtroje veprimtari, kryesisht, bar, restorant, shërbime *catering*, shitje me pakice të ushqimeve dhe pijeve të ndryshme, pranë Aeroportit Ndërkombëtar “Nene Tereza” në përputhje me kontratën e koncesionit të lidhur me Tirana International Airport Shpk. si dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur në përputhje me këtë kontratë koncesioni.
- 5.2 Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji.

Neni 6

**Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 leke (*njëqind mijë*).
- 6.2 Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë përbehet nga 1 (*një*) kuote me vlerë nominale 100.000 leke (*njëqind mijë*).

Neni 7

**Ortaku i Vetem**

Ortaku i Vetem i Shoqërisë është:

- **Helios Gastronomi Shpk**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numer unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L32222023L, zoterues i 1 (*një*) kuote që i korrespondon 100% (*një qind për qind*) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën 100.000 leke (*njëqind mijë*).

Neni 8

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar**

- 8.1 Kapitali i themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë keste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetem në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 8.2 Shoqëria mund të zvogelojë kapitalin themeltar, me vendim të Ortakut të Vetem në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën minimumin e përcaktuar në ligj.

   
2

Neni 9

**Transferimi i kuotes**

Ortaku i Vetem mund te vendose per transferimin e kuotes permes shitjes, dhurimit, trashegimise apo ndonje menyre tjeter te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 10

**Vendimmarrja**

- 11.1. Organi me i larte vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem.
- 11.2 Ortaku i Vetem eshte pergjegjes nder te tjera per vendime ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:
- i. ndryshimi i statutit;
  - ii. emerimi dhe shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel dhe likuidatoreve dhe shperblimi i tyre;
  - iii. zmadhimi dhe/ose zvogelimi i kapitalit;
  - iv. transferimi i kuotes;
  - v. shperndarja e fitimit;
  - vi. riorganizimi dhe/ose likuidimi i Shoqerise; dhe
  - vii. çdo ceshtje tjeter te parashikuar nga legjislacioni i zbatueshem dhe ky akt.

Neni 11

**Regjistri i Vendimeve**

- 11.1 Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, vendimet per:
- i. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - ii. Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar;
  - iii. shperndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - iv. investimet;
  - v. vendimet per riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- 11.2 Lista e mesiperme nuk eshte shteruese dhe vendimet e paregjistruara ne Regjistrin e Vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.



Ornelo Dlekeci  
30

## Neni 12

### Administrimi

- 12.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratore. Administratori i parë i Shoqërisë është:
- **Z. Dalip Çizmjë**, shtetas shqiptar, lindur më 19.10.1981, në Tiranë, Shqipëri mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I11019125C.
- 12.2 Administratori/et do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetem dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtit.
- 12.3 Administratori/et është person fizik, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohezgjatja e mandatit të Administratorit/eve do të vendoset në momentin e emerimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pese) vjeçar. Pavarësisht kësaj kufizimi, kohezgjatja e mandatit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetem.

## Neni 13

### Kompetencat e Administratorit

- 13.1 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me të palet e treta, në përputhje me dispozitat e kësaj akti dhe legjislacionin e zbatueshëm.
- 13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetem;
  - sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
  - kryerjen e të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
  - mirembajtjen e rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabel të Shoqërisë;
  - perfaqësimin e Shoqërisë me palet të treta;
  - kryerjen e të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, bazuar në legjislacionin në fuqi;
  - kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këto akt.



*Ornela Shkëlli*



- 13.3 Administratori mund të ushtroje të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky akt janë të rezervuara për Ortakun e Vetem ose kufizohen nga ky akt apo legjislacioni i zbatueshëm.
- 13.4 Administratori mund të delegojë pjesë ose tërë kompetencat e tij tek persona të tjerë.

#### Neni 14

##### **Eksperti kontabel i autorizuar**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetem, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhenave kontabel të Shoqërisë do t'i besohet një ose me shumë eksperteve kontabel të autorizuar.

#### Neni 15

##### **Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare**


- 15.1 Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Viti i parë ushtrimor do të fillojë ditën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe do të mbarojë me 31 Dhjetor 2020.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëse ka një të tilla, miratohen nga Ortaku i Vetem në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 15.4 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

#### Neni 16

##### **Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë**

- 16.1 Ortaku i Vetem mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.
- 16.2 Ortaku i Vetem do të emerojë një ose me shumë likuidues, dhe përcakton tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 16.3 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevojat e likuidimit deri në përfundim të këtij procesi dhe gjatë likuidimit të përbashkët "në likuidim të siper" duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.



Ornela Allesku  


Neni 17

**Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 17.1 Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet te kryhen ne përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Persa nuk parashikohet ne këtë akt do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, te ndryshuar.
- 17.2 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor te Tiranës.

*Ky akt përpilohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhën shqipe.*

**ORTAKU I VETEM**

*Amxheta Kola*



*Onela Kleska*